



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:279193

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05540339

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurve B.. B..., B.. B.. dhe K.. B.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.2367/22 të datës 23.12.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 03.04.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.35/24 e datës 21.02.2024 e lidhur në mesë të pandehurve B.. B..., B.. B... dhe K.. B... dhe të dëmtuarit L.. G.. me përfaqësuesi ligjor T.. G.. nga P.. rr. E.. B...

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II-nr.2637/22 të datës 23.12.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurve:

B.. B..., i lindur më 12.09.1976 në Pejë, me vendbanim në Rr. V... D.." nr.. K. P..., i biri i B..., nënës S., e vajzërisë A., ka te kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, posedues i nr te telefonit, i identifikuar me nr personal, i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

B.. B..., i lindur më 05.12.1981 në Pejë, me vendbanim në Rr"V... D..." nr.... K.. P., i biri i B., nënës S., e vajzërisë A., ka te kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, posedues i nr te telefonit, i identifikuar me nr personal, i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

K.. B..., i lindur më 02.05.1996 në Pejë, me vendbanim në Rr"V... D..." nr.16 K. P., i biri i B., nënës S., e vajzërisë A., ka te kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, posedues i nr te telefonit, i identifikuar me nr personal, i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

- për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga nenin 185 par. 1 nen par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 2.12.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2367/22 ndaj të ndaj të pandehurve B.. B..., B.. B.. dhe K.. B.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 21.02.2024 pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit dhe të dëmtuarit L.. G.. me përfaqësuesi ligjor T.. G.. nga Peja rr. E.. B., gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka aprovuar propozimin e të pandehurve që kjo çështje penale të referohet ne procedurë te ndërmjetësimit.

Me datën 21.02.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurve B.. B..., B.. B... dhe K.. B... dhe të dëmtuarit L.. G.. me përfaqësuesi ligjor T.. G.. nga Peja rr. E.. B..., , e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../. e datës 21.02.2024 e lidhur në mesë të pandehurve B.. B..., B.. B... dhe K.. B... dhe të dëmtuarit L.. G.. me përfaqësuesi ligjor T.. G.. nga Peja rr. E.. B....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:279193, 03.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.